



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 854/2 Prot.

Vlorë më, 17.06. 2022

VENDIM
Nr. 27, datë 16.06.2022

PËR
NJË SHITESË MBI KRITERET E PRANIMIT PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË
TRETË TË STUDIMIT "DOKTORATË" NË "STUDIME GJUHËSORE, LETRARE
E KULTURORE" MIRATUAR ME VENDIM SA NR.6, DATË 02.02.2022

Në mbështetje të nenit 38, 78,79 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gwrma f, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Rregullores për organizimin e programit të studimit "Doktoratë" miratuar me vendim SA nr. 43, datë 15.11.2021 si dhe referuar shkresës nr. 273/1 prot, datë 14.06.2022 të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, të UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.06.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriterin e intervistës në kriteret bazë të pranimit të aplikantëve në studimet e doktoraturës. Intervista do të bazohet në këto elemente:
 - Veprimtaria kërkimore shkencore e aplikantit
 - Qëllimi/ objektivat/ qasja dhe mënyra si është ndërtuar projektpropozimi
 - Rezultatet e pritshme
 - Pyetje/ përgjigje të ndryshme plotësuese.
2. Kriteret e miratuara i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola AGARAJ

